



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/

Datë: 28.12.2018

PRANUAR

ACCEPTED

PRIMLJENO

Nr. No. Br.

28/12/2018.

02-581

Procesverbal

i mbledhjes se VIII (tetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes se -VII- të KPF-së.
2. Informimi për realizimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2018.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
4. Shqyrtimi dhe miratimi përfundimtar i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
6. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 10.12.2018, filloj në ora 11, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim, qytetar.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve në mbledhje, rendin e ditës me materialet i keni, por kemi edhe disa kërkesa.

Alban Krasniqi: Rregullorja për tokën bujqësore është vonuar, ka qenë mirë kryesues me biseduar me drejtorin e drejtorisë për Bujqësi. E dyta në Qershor kemi marrë vendim për pagesën e tri pagave përcjellëse për të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë, kjo deri tani nuk është realizuar ka qenë mirë më fut në rend dite, ta diskutojmë dhe brenda një afati që ne i japim me na sjellë raport kah mund t'i sigurojnë ato mjete. E treta në lidhje me objektin e Kryqit të Kuq në Malishevë që tani edhe kanë bërë kërkesë duhet të kërkojmë gjendjen pronësorë, juridike për atë objekt, sepse ai objekt është objekt publik.

Rahim Morina: Kryqi i Kuq ka kërkuar lokacion ku kane qenë zyrat e ish KEK mbrapa objektit të qendrës për punë sociale tani që është aty. Kanë thënë se ka hapësirë për tu vendosur me zyre dhe depo. Ne do të kërkojmë sqarime nga drejtoritë.

A jeni për këtë rend të ditës?

Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së për rendin e ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes se -VII- të KPF-së.

Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së, për miratimin e procesverbalit.

2. Informimi për realizimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2018.

Rahim Morina: Në do ta plotësojmë planin e punës për vitin 2019.

Alban Krasniqi: Mirë është të ceken vendimet që janë miratuar.

Rahim: A jeni këtë pikë ta rekomandojmë për Kuvend.

Alban Krasniqi: Te bëhet edhe një raport të përshkruhen sa mbledhje, sipas kërkesës së kujt të ceken rekomandimet dhe përfundimi në raport.

Raimonda Krasniqi: Është mirë të specifikohen dhe të qiten në formë tabelare sa mbledhje të rregullta, sa urgjente dhe sa të jashtëzakonshme.

Rahim Morina: a jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për 4 snetsrët e KPF-së.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Rahim Morina: Planin e punës për vitin 2019 do të bëhet nga Komisioni i formuar nga Kuvendi.

Alban Krasniqi: Në si komision e punojmë Planin e punës në një mbledhje, mbledhjen tjetër shohim se a ka nevojë të shtojmë diçka dhe pastaj e kalojmë për Kuvend për miratim.

Raimonda Krasniqi: Propozoj që mbledhjet e KPF-së, dhe mbledhjet e Kuvendit vitin që vjen të mbahen ditëve të Premte.

Alban Krasniqi: Edhe unë jam që mbledhjet të mbahen të Premten.

Rrahim Morina: A jeni që këtë pikë ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

4. Shqyrtimi dhe miratimi përfundimtar i Draft-Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2019.

Rrahim Morina: Procedurat për këtë Rregullore kanë përfunduar me debat publik edhe pse neper debate nuk po marrin pjesë shumë qytetarë, tani kjo ka mbete veç për miratim nga Kuvendi.

Alban Krasniqi: Ne duhet me këqyr se a dojmë më ru Malishevën si nga rasti i gurëthyesve dhe çka mundemi me evitua, me këqyr koston dhe përfitimet. Mi dekurajua njerëzit ose mi leju por që ne duhet me kanë me të zëshëm. Ne duhet me vendosë shuma si masë e shprehur, sepse koha e gurëthyesve ka kaluar dhe ajo shumë me kanë e pa përballueshme për gurëthyesit. Qytetarët duhet me ndi veten me të shëndetshëm dhe me të sigurte e ne këtë zeje me dekuraju, e të krijohet ndonjë zeje si Bujqësia, ose me vendos taksë zero.

Rrahim Morina: A jeni që këtë pikë ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

5. Shqyrtimi i zbatimit të vendimit për pagesën e tri pagave përcjellëse për punëtorët e Arsimit, shëndetësisë dhe të administratës të pensionuar nga viti 2015, 2016 dhe deri me 31 dhjetor 2018.

Alban Krasniqi: Ky vendim deri tani sa zbatuar, Kryetari ka thënë se kanë pengesa me zbatuar vendimin prej Ministrisë, unë sa jam interesuar tani palët po i drejtohen Gjykatës për t'i marrë ato paga dhe se paku 300 euro i krijohen Komunës shpenzime nga secili rast në Gjykatë. Ne duhet të kërkojmë sqarime nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa se nga i sigurojnë ato mjete për pagesë, dhe ta sjellin numrin e punëtorëve prej vitit 2015 deri me 2018.

Rrahim Morina: A jeni që këtë pikë ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

6. Shqyrtimi dhe rekomandimi për Kuvend për miratim të Rregullores për tokën bujqësore.

Rrahim Morina: Edhe për këtë Rregullore janë kryer të gjitha procedurat. A jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

7. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/492 datë: 26.11.2018 e parashtruar nga përfaqësuesi i Kryqit i Kuq i Kosovës-Dega në Malishevë.

Rrahim Morina: Përfaqësuesi i Kryqit të Kuq ka kërkuar lokacion pasi që te objekti ku janë ju ka pamundësuar të punohet, për shkak të një objekti që po e ndërton terasën aty. Mirë është t'i bëjmë një zgjidhje.

Alban Krasniqi: Prej pas Luftës e deri me tani kjo organizatë ju ka qendru afër familjeve me ndihma sociale, trajtimin e dhunës, trajnime, shkollime. Tani rastet e natyrës sociale po rriten e funksionimi i këtyre organizatave është në rëzik, e rritja e organizatave për biznes siç ka qenë ajo organizata Malasi që ka pas marrë mjetë në Komunë, e këto organizata që ndihmojnë nuk po u ndihmohet kur kanë nevojë.

Ai objekt ku janë kërkon investim e ai objekt aty a i plotëson kushtet. Zyret në objektin e Dardanisë, edhe aj objekti të zjarrfikësit, ose te Muzeu që se shfrytëzon askush munden mu kriju si hapësirë për zyrë për Kryqin e Kuq.

Nga drejtoria për Financa është mirë të kërkohet a ka hapësira te aj objekti i Dardanisë për zyrë dhe në çfarë gjendje janë.

Raimonda Krasniqi: Mirë është me pas informacione pasi që kjo organizatë ka kërkuar hapësirë për zyrë, dhe me ditë a mundet Komuna me rinovuar objektin aty ku janë, dhe a ka punëtor tjerë përveç atij zyrtarit. Me kerku informacion së lokalet të Muzeu, të zjarrfikësit, objekti të dardania për këtë Organizatë, pra me ditë sa është hapësira e tyre dhe gjendja.

Rrahim Morina: A jeni ta rekomandojmë këtë kërkesë për Kuvend? Unanimisht ishin për te gjithë.

Kërkesa nr.02/507 datë: 04.12.2018 nga Arsim Krasniqi nga fshati Terpezë e Poshtme.

Alban Krasniqi: Mirë është të kërkojmë sqarime nga Gjeodezia rreth azhurimit të datave, 22.08 dhe 29.06.2018 që ceken në fletën poseduese.

Rrahim Morina: Drejtorisë për Gjeodezi i kërkojmë sqarime në lidhje me këtë kërkesë.

8. Të ndryshme

Rrahim Morina: Nëse dikush nuk ka diçka atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:50 minuta.

Procesmbajtësi:

Naim Azdijaj jur. i dip

Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina